



**BASHKIA TIRANË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 9 datë 20.02.2017

**Për**

**NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.21 DATE 18.07.2012 PER  
“MIRATIMIN E ANËTARËSIMIT DHE FINANCIMIT TE KUOTËS SË ANËTARIT TË  
ASOCIUAR TË BASHKISË SË TIRANËS  
NË EUROCIITIES, RRJETI I QYTETEVE MË TË MËDHA EUROPIANE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/ 1.1, shkronja “b”, pika 1/ 1.5, pika 1/ 1.6, nenit 25, nenit 54, shkronja “d”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 10, pika 2 të Ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 për “Ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”; nenit 4, të Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 për “Organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 18.07.2012 për “Miratimin e anëtarësimit dhe financimit të kuotës së anëtarit të asociuar të Bashkisë së Tiranës në Eurocities, rrjeti i qyteteve më të mëdha Europiane”; Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 84, datë 29.12.2016 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017 - 2019 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë një ndryshim në pikën 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.21 datë 18.07.2012 si më poshtë:
  - *Të përmbushë detyrimin e pagesës vjetore të kuotës si anëtar i asociuar në Eurocities, në shumën 4260 (katërmijëedyqindegjashtëdhjetë) Euro në vit, për vitin 2017 e në vijim.*
2. Për vitin 2017, fondi për pagesën vjetore të kuotës si anëtar i asociuar prej 4260 (katërmijëedyqindegjashtëdhjetë)euro do të përballohet nga buxheti i aparatit të Bashkisë, në Programin e Administratës Vendore për kuota anëtarësie.
3. Shpenzimet për të mbuluar diferencat që kanë rrjedhur nga ndryshimi i nivelit të kuotës vjetore nga 4000(katërmijë) Euro në 4260(katërmijëedyqindegjashtëdhjetë) Euro,do të

përballohen nga buxheti i aparatit të Bashkisë për vitin 2017, në Programin e Administratës Vendore për kuota anëtarësie.

4. Të shfuqizojë pikën 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 18.07.2012.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**